



8 prill 2016

KOMUNIKATË PËR SHTYP

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut ka miratuar mendimin e tij për rastin *N.M. dhe të tjerët kundër UNMIK-ut (nr. 26/08)*

Më 26 shkurt 2016, gjatë sesionit të 91-të të mbajtur në Prishtinë, Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut (Paneli) ka miratuar mendimin e tij lidhur me rastin *N.M. dhe të tjerët kundër UNMIK-ut*. Ankuesit janë 138 pjesëtarë të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian (RAE) në Kosovë, të cilët kanë banuar në pesë kampe për Persona të Zhvendosur Brenda Vendit (PZhBV) në Mitrovicën e veriut, të cilët administroheshin nga UNMIK-u.

Gjatë konfliktit të armatosur të vitit 1999 në Kosovë, shumë romë që më parë kishin jetuar në Mëhallën Rome në Mitrovicën e jugut kishin ikur në Mitrovicë të veriut si pasojë e dhunës ndëretnike dhe e shkatërrimit të shtëpive të tyre. Përafërsisht rreth 600 romë ishin vendosur në kampe të PZhBV-ve (Zhikoc, Çesminlug, Kablare, Leposaviq dhe Osterode) afër shkritores së Trepçës dhe vendeve të saj për deponimin e mbetjeve të minierave.

Afro gjysma e ankuesve ishin fëmijë në kohën kur ankesa i është parashtruar Panelit. Rreth 75 ankuese janë gra dhe vajza. Së paku 13 prej tyre kanë lindur foshnje në këto kampe, dhe kanë parashtruar ankesa edhe në emër të fëmijëve të tyre.

Të gjithë ankuesit pretendojnë se janë helmuar nga plumbi dhe se kanë pasur probleme të mëpasme shëndetësore për shkak të kontaminimit të dheut në lokacionet e kampeve si rrjedhojë e afërsisë së tyre me shkritoren e Trepçës dhe me kompleksin e minierave dhe për shkak të pastërtisë dhe kushteve jetësore në përgjithësi të dobëta në kampe. Pesë ankues deklarojnë se anëtarët e tyre të familjeve kanë vdekur në kampe si rezultat i helmimit me plumb.

Ankuesit pretendojnë se UNMIK-u ka shkelur të drejtat e tyre të njeriut, duke i vendosur ata në kampe të PZhBV-ve që gjendeshin në tokën, për të cilën dihej se ka kontaminim të lartë, duke mos ua dhënë atyre informatën me kohë lidhur me rreziqet shëndetësore apo me kujdesin e duhur shëndetësor, si dhe duke mos i rivendosur ata në një vend të sigurt.

Paneli ka konstatuar se UNMIK-u ka shkelur të drejtën e ankuesve në jetë, në aspektet e saj substantive dhe procedurale, ashtu siç garantohet në nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj), të drejtën e tyre për mos u trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe poshtëruese (neni 3 i KEDNj-së) dhe të drejtën e tyre për respektim të jetës private dhe familjare (neni 8 i KEDNj-së). Paneli gjithashtu ka

konsideruar që dështimi i UNMIK-ut për t'i rivendosur ata në një vend të sigurt ka përbërë diskriminim ndaj ankuesve si pjesëtarë të komunitetit RAE që paraqet shkelje të nenit 14 të KEDNj-së, ku përfshihen edhe dispozitat e KEDNj-së të cekura më lartë, të neneve 2 dhe 26 të Konventës ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, si dhe të nenit 2 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK).

Paneli më tej ka konstatuar se kushtet jo të shëndetshme dhe johigjienike në kampe kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankuesve për standard të duhur të jetesës, duke përfshirë edhe të drejtën për banim (neni 11 i KNDESK) dhe të drejtën për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit (neni 12 i KNDESK).

Lidhur me ankueset femra, Paneli ka konsideruar se edhe ato u janë nënshtruar diskriminimeve të shumta në gëzimin e të drejtave themelore që i kanë si femra, si PZhBV dhe si pjesëtare të komunitetit RAE, të cilat paraqesin shkelje të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Femrave (KEFDF). Paneli po ashtu ka konstatuar se UNMIK-u është përgjegjës për rrezikimin e pakthyeshmë të jetës, shëndetit dhe të potencialit zhvillimor të ankuesve që janë lindur dhe janë rritur si fëmijë në kampe, gjë që parqet shkelje të neneve 3, 6, 24, 27 dhe 37 të Konventës për të drejtat e fëmijës.

Paneli ka dhënë një numër rekomandimesh për UNMIK-un, duke përfshirë në mes të tjerash, që të bëjë pranimin publik të dështimit të tij në respektimin e standardeve në fuqi të të drejtave të njeriut si reagim ndaj kushteve të rënda të jetesës, të shkaktuara nga kontaminimi me plumb në kampet e PZhBV-ve, dhe pasojave të mëvonshme ndaj ankuesve, si dhe që të bëjë kërkimfalje publike ndaj atyre dhe familjeve të tyre.

Paneli gjithashtu ka rekomanduar që UNMIK-u të ndërmerr hapat e duhur drejt pagesës së kompensimit adekuat për dëmin material dhe moral lidhur me konstatimin e shkeljeve të dispozitave për të drejtat e njeriut, të cekura në këtë mendim.

Paneli njashtu ka rekomanduar që UNMIK-u të ndërmerr hapat e duhur për t'u siguruar që organet e OKB-së që punojnë me refugjatë dhe PZhBV-të të promovojnë dhe sigurojnë respektim të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe konstatimet e rekomandimet e Panelit për këtë rast u janë dërguar organeve të tilla si garanci e mospërsëritjes. Paneli po ashtu ka rekomanduar që UNMIK-u të realizojë hapat e duhur drejt organeve të OKB-së për të siguruar shpërndarjen e efektshme të informatave relevante për shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve nën autoritetin dhe kontrollin e tyre.

Përveç kësaj, Paneli i rekomandoi UNMIK-ut që të nxisë organet e OKB-së dhe autoritetet relevante në Kosovë për të mbrojtur dhe avancuar të drejtat e njeriut të popullit rom, posaçërisht të femrave dhe fëmijëve, duke siguruar që ata të kenë rol proaktiv.

Teksti i plotë i mendimit në gjuhën angleze mund të gjendet në faqen e internetit të PKDNj-së <[këtu](#)>. Versionet në gjuhën shqipe dhe serbe do të vihen në dispozicion pas përkthimit.

Kjo komunikatë për shtyp është dokument i hartuar nga Sekretaria e Panelit dhe nuk e obligon Panelin. Për informata të tjera, luteni të kontaktoni z. Andrey Antonov, zyrtarin ekzekutiv të Sekretarisë së Panelit përmes postës elektronike: antonov@un.org, tel: +381 (0)38 504 604 lok. 5847. Vendimet, mendimet dhe informatat e tjera për Panelin mund të gjenden në faqen e tij të internetit: www.unmikonline.org/hrap